



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

I PËRDITËSUAR

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr.10/2021¹

**PËR USHTRIMIN E FUNKSIONIT TË MONITORIMIT NË SISTEMIN E
PROKURORISË DHE BASHKËPUNIMIN ME INSTITUCIONET KUSHTETUESE
DHE LIGJORE**

(Disa shtesa me Udhëzimin e Përgjithshëm nr.4, datë 18.10.2022²)

Në mbështetje të neneve 148 pika 2 dhe 148/b shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 38 pika 1 dhe pika 2 shkronjat “b”, “f”, “g”, “gj” dhe “i”, 42 shkronja “dh”, “gj” e “k”, 46 pika 3 shkronjat “c” e “ç”, 51 pikat 1 e 4, dhe vijues të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, neneve 7 pika 6, 35 pika 2 shkronjat “a” e “b” e vijues të ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, nenit 194 pika 1 shkronjat “c”, “d” e pika 4 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, nenit 119 pika 2 shkronja “c” e vijues të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe kërkesën³ e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë “Për veprimtarinë e prokurorisë...” datë 14.06.2021, si dhe rekomandimet e Rezolutës⁴ së Kuvendit të Shqipërisë, datë 14.07.2022..

¹ Shih, udhëzimi i përgjithshëm i PP nr.10, datë 30.12.2021 me të njëjtin titull;

² Shih, udhëzimi i përgjithshëm i PP nr.4, datë 18.10.2022 “Për disa shtesa në udhëzimin e përgjithshëm nr.10, datë 30.12.2021 “Për ushtrimin e funksionit të monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkëpunimin me institucionet kushtetuese dhe ligjore”.

³ Shih, pikën 8 të kërkesës së Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë “Për veprimtarinë e prokurorisë...” miratuar me datë 14.06.2021, ku parashikohet: “Për vitin 2021, Kuvendi i Shqipërisë kërkon nga Prokuroria e Republikës së Shqipërisë: 8. Të miratohen projektudhëzimet e përgjithshme “Për funksionimin e strukturës së monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkërendimi me institucionet kushtetuese përkatëse”.....”

⁴ Shih, pikën 4 të rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë “Për veprimtarinë e prokurorisë për vitin 2021” miratuar me datë 14.07.2022, parashikohet: “Për vitin 2022, Kuvendi i Shqipërisë i rekomandon institucionit të Prokurorisë së Përgjithshme: 4. Të punohet për forcimin e mekanizmave për rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së brendshme të oficerëve të policisë gjyqësore, për efikasitetin dhe punën, pa cënuar procesin e rregullt ligjor gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre ...”

UDHËZOJ:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi të përgjithshëm është unifikimi i ushtrimit të funksioneve mbikëqyrëse dhe verifikuese nga strukturat përkatëse dhe/ose nga autoriteti i monitorimit në sistemin e prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm, për të garantuar zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme dhe si kanë ndikuar ato në efikasitetin dhe/ose efektivitetin e ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore të prokurorisë në drejtimet e udhëzuara dhe/ose rekomanduara, si dhe për iniciimin e inspektimeve tematike në strukturat përkatëse ose hetimeve për shkelje individuale të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve e shërbimeve policore sipas ligjit në bashkëpunim me Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë dhe Komisionin e Policisë Gjyqësore, për të siguruar pavarësinë/autonominë e prokurorit në ushtrimin e funksioneve dhe mbarëvajtjen, efikasitetin, ligjshmërinë dhe transparencën në veprimtarinë e sistemit të prokurorisë.

Neni 2

Objekti

1. Objekt i këtij udhëzimi të përgjithshëm janë:

a) përcaktimi i funksioneve mbikëqyrëse ose verifikuese dhe i strukturës ose autoritetit të zbatimit të tyre;

b) përcaktimi i rregullave për mënyrën e mbikëqyrjes së zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme, veprimtarisë së policisë gjyqësore dhe marrjes së informacionit nga strukturat në Prokurorinë e Përgjithshme në bashkërendim me autoritetin e monitorimit/mbikëqyrjes në prokuroritë përkatëse;

c) përcaktimi i mënyrës së mbikëqyrjes dhe rregullave për verifikimin e indicieve, informacioneve ose ankesave për problematikat apo shkeljet e konstatuara apo të pretenduara dhe bashkëpunimi me strukturat përkatëse në prokurori dhe me institucionet kushtetuese dhe ligjore.

Neni 3

Parimet

1. Në ushtrimin e funksioneve sipas këtij udhëzimi respekton e garantohen parimet:

- a) ligjshmëria;
- b) pavarësia e prokurorëve;
- c) objektiviteti;
- ç) transparenca;
- d) llogaridhënia;
- dh) konfidencialiteti i të dhënave që vihen në dijeni dhe ruajtja e sekretit të hetimeve.

KREU II

STRUKTURAT DHE AUTORITETET MBIKËQYRËSE DHE FUNKSIONET E TYRE

Neni 4

Strukturat dhe autoritetet mbikëqyrëse dhe verifikuese

1. Strukturat në Prokurorinë e Përgjithshme kryejnë funksione mbikëqyrëse dhe verifikuese sipas ligjit⁵ dhe akteve nënligjore⁶.

1.1 Sektori i Monitorimit në këtë Prokurori është struktura e autorizuar nga Prokurori i Përgjithshëm⁷, në funksion të ushtrimit edhe të kompetencave të parashikuara në shkronjat “g”, “gj” e “i” të nenit 38 të ligjit nr.97/2016⁸, pikën 2 të nenit 35 të ligjit nr.25/2019⁹ dhe në këtë udhëzim.

2. Në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm autoriteti monitorues/mbikëqyrës dhe verifikues sipas ligjit¹⁰ dhe këtij udhëzimi është drejtuesi i prokurorisë ose zëvendës drejtuesi i autorizuar prej tij, dhe sipas ligjit¹¹.

Neni 5

Funksionet mbikëqyrëse ose verifikuese dhe struktura/autoriteti i kryerjes së tyre

1. Funksionet mbikëqyrëse dhe verifikuese të kryera nga strukturat në Prokurorinë e Përgjithshme lidhur me veprimtarinë e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm,

⁵ Shih, nenin 38 në lidhje me nenet 14, 65 e vijues të ligjit nr.97/2016 i ndryshuar, nenin 25 pika 1 shkronja “b” e K.Pr.Penale i ndryshuar, dhe nenin 7 pika 6 e ligjit nr.25/2019.

⁶ Shih, Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme, e miratuar me urdhërin nr.136, datë 28.10.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm;

⁷ Shih, nenin 38 pika 3 në lidhje pikën 2 shkronjat “b”, “g”, “gj” e “i”, dhe neni 50 pika 1 e 4, e vijues ligjit nr.97/2016 i ndryshuar;

⁸ Ligji nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

⁹ Ligji nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, i ndryshuar;

¹⁰ Shih, nenin 42 shkronjat “dh” “e” “g”, “gj”, “k”, e “i”, nenin 43 “shkronja “dh” e “e”, nenit 46 pika 4, neni 50 pikat 2, 3 e 4 e vijues të ligjit nr.97/2016 i ndryshuar;

¹¹ Shih, nenin 44 e vijues të ligjit nr.97/2016 i ndryshuar;

seksioneve të policisë gjyqësore pranë tyre dhe shërbimeve të policisë gjyqësore sipas ligjit¹², janë të grupuara në këto drejtime:

a) Ushtrimi i kompetencave kushtetuese dhe ligjore në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm dhe në seksionet e policisë gjyqësore pranë tyre sipas ligjit¹³;

b) Zbatimi i kuadrit ligjor të sistemit të drejtësisë penale¹⁴ nga prokurorët e prokurorive të apeleve dhe prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, oficerët e policisë gjyqësore pranë tyre, dhe jo vetëm, në kryerjen e hetimeve, ushtrimin e ndjekjes penale, ngritjen/përfaqësimin e akuzës në gjyq, ekzekutimin e vendimeve penale dhe mbikëqyrjen e zbatimit tyre, trajtimin e të paraburgosurve, dënuarve ose viktimave në procesin penal, evidentuar në përfaqësimin e çështjeve në Gjykatë të Lartë ose Gjykatën Kushtetuese;

c) Zbatimi i urdhrave dhe udhëzimeve të përgjithshme¹⁵ të Prokurorit të Përgjithshëm nga ana e drejtuesve, prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe punonjësve administrativë, sipas disponimeve të veçanta të parashikuara në aktin normativ konkret, si dhe rezolutave të Kuvendit të Shqipërisë dhe rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave, dhe jo vetëm¹⁶;

ç) Përmbytja dhe saktësia e të dhënave të raportit vjetor mbi ecurinë e punës në prokurorinë përkatëse përgjatë vitit paraardhës sipas ligjit¹⁷;

d) Veprimtaria organizative dhe funksionale e Policisë Gjyqësore të Seksioneve pranë prokurorive dhe veprimtaria funksionale e shërbimeve të policisë gjyqësore në strukturat përkatëse, si dhe bashkërendimi e koordinimi i punës tyre me prokuroritë pranë të cilave ushtrojnë funksionet e tyre.

1.1 Struktura e monitorimit, në zbatim të kompetencave të parashikuara në nenin 4 pika 1.1 të këtij udhëzimi, vlerëson dhe/ose verifikon indiciet apo informacionet për probleme tematike ose për shkelje individuale të evidentuara kryesisht ose nga veprimtaria funksionale e strukturave të Prokurorisë së Përgjithshme e parashikuar në pikën 1 të këtij neni ose nga ankesa të dërguara nga persona fizik apo juridik në Prokurorinë e Përgjithshme.

a) Kjo strukturë, sipas rastit dhe në zbatim të ligjit¹⁸, vlerëson dhe harton projekt kërkesa/ankesa drejtuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ose Komisionit të Policisë Gjyqësore, të cilat vleresohen nga Prokurori i Përgjithshëm dhe në rastet kur ka të dhëna të besueshme se është kryer shkelje disiplinore i dërgohen institucioneve përkatëse.

¹² Shih, nenin 31 pika 1 shkronja "a" e vijues e K.Pr.Penale dhe nenin 2 pika 3 dhe nenin 12 të ligjit nr.25/2019.

¹³ Neni 38, pika 2 shkronjat "f", "g", "gj" e "i" e ligjit nr.97/2016 dhe nenit 7 pika 6 e ligjit nr.25/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore;

¹⁴ Shih, Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale, Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, ligji nr.79/2020 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", ligji nr.

¹⁵ Neni 38, pika 2 shkronja "b" e ligjit nr.97/2016;

¹⁶ Koment: Rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare (OKB, KE, KiE, FATF/ICRG, MONEYVAL, etj) etj, për Shqipërinë, ku përfshihet fusha e veprimtarisë institucionale e prokurorisë.

¹⁷ Neni 50, pikat 2, 3, 4 e 5 të ligjit nr.97/2016;

¹⁸ Neni 38, pika 2 shkronjat "g" e "i" të ligjit nr.97/2016, nenit 35 pika 2 shkronja "a" e ligjit nr.25/2016 dhe nenit 194 pika 2 shkronja "c" dhe pika 4 e ligjit nr.115/2016;

2. Funksionet mbikëqyrëse apo verifikuese të Drejtuesit të prokurorisë në kompetencë dhe përgjegjësinë e tij, sipas ligjit¹⁹ janë të grupuara në këto drejtime:

a) Mbarëvajtja e punës dhe marrja e masave dhe veprimeve për të siguruar efikasitetin dhe ligjshmërinë e veprimtarisë së prokurorisë²⁰;

b) Disiplina në punë e prokurorëve sipas ligjit²¹;

c) Garantimi i zbatimit korrekt të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm sipas ligjit²², nxjerrja e udhëzimeve të përgjithshme për çështje të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë që drejton, si dhe për lehtësimin e zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm²³;

ç) Respektimi i etikës së prokurorit, planifikimi i punës së tyre dhe përmbushja e angazhimeve ligjore për vlerësimin profesional të prokurorëve dhe/ose oficerëve të Policisë Gjyqësore²⁴;

d) Veprimtaria e Policisë Gjyqësore në juridiksionin e tij²⁵;

2.1 Drejtuesi i prokurorisë konstaton, vlerëson dhe/ose verifikon shkelje individuale të evidentuara nga veprimtaria mbikëqyrëse në pikën 2 të këtij neni, ose nga informacione apo ankesa të ardhura në prokurorinë që drejton.

a) Ky autoritet, sipas rastit dhe në zbatim të ligjit²⁶, vlerëson, dhe kur ka të dhëna të besueshme se është kryer shkelje disiplinore harton dhe dërgon kërkesat/ankesat drejtuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ose Komisionit të Policisë Gjyqësore, si dhe sipas ligjit²⁷ vlerëson informimin për dijeni strukturën përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme.

2.2 Në rastet kur Drejtuesi i prokurorisë nga veprimtaria mbikëqyrëse konstaton dhe vlerëson probleme tematike apo shkelje individuale, ose kur ka indicie, informacione ose ankesa për probleme të së njëjtës natyrë, sipas rastit vlerëson informon e Prokurorit të Përgjithshëm sipas ligjit²⁸.

3. Në ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse të policisë gjyqësore nga prokurori i çështjes, sipas ligjit²⁹, në rastet kur vlerëson se ka të dhëna të besueshme se për çështjen që ka në ndjekje është kryer shkelje disiplinore nga oficeri i policisë gjyqësore përkatës, harton dhe dërgon kërkesë/ankesë drejtuar Komisionit të Policisë Gjyqësore, si dhe sipas ligjit³⁰ vlerëson informimin për dijeni drejtuesin e Prokurorisë dhe/ose Prokurorin e Përgjithshëm

¹⁹ Shih, nenin 42 shkronjat “dh” “e” “g”, “gj”, “k”, e “i”, nenin 43 “shkronja “dh” e “e”, nenit 46 pika 4, dhe neni 50 pikat 2, 3 e 4 e vijues të ligjit nr.97/2016 i ndryshuar, dhe nenin 7 pika 6 e ligjit nr.25/2019.

²⁰ Neni 52, pika 1 e ligjit nr.97/2016;

²¹ Neni 42, shkronja “dh” të ligjit nr.97/2016;

²² Neni 42, shkronja “g” dhe 43 shkronja “dh” ligjit nr.97/2016;

²³ Neni 46, pika 4 e ligjit nr.97/2016;

²⁴ Neni 42, shkronja “gj” e “k” të ligjit nr.97/2016;

²⁵ Neni 42, shkronja “gj” e ligjit nr.97/2016;

²⁶ Neni 42, shkronjat “dh”, “gj” e “k” të ligjit nr.97/2016, nenit 35 pika 2 shkronja “b” e ligjit nr.25/2016 dhe nenit 194 pika 2 shkronja “dh” e ligjit nr.115/2016;

²⁷ Neni 42, shkronjat “e” e ligjit nr.97/2016;

²⁸ Neni 42, shkronjat “e” e “k”, neni 50 pika 1 në lidhje me nenin 38 pikat 1, 2 shkronjat “b”, “f” e “i” e vijues të ligjit nr.97/2016;

²⁹ Shih, nenet 24 pika 1, 30 pika 2, 277 pika 2, 304 e vijues të K.Pr.Penale dhe nenin 7 pika 2 në lidhje me nenin 35 pika 2 shkronja “ç” e vijues të ligjit nr.25/2019.

³⁰ Neni 42, shkronjat “gj” dhe nenin 38 pikat 1, 2 shkronjat “b”, “f” e “i” e vijues të ligjit nr.97/2016;

KREU III

MËNYRAT, FORMAT DHE MJETET E MBIKËQYRJES OSE VERIFIKIMIT

Neni 6

Mënyra dhe mjetet e kryerjes së mbikëqyrjes ose verifikimeve

(Shtesat në pikën 1 shkronjat "a" e "ç", pikën 3 shkronja "ç/i" dhe pikën 3/1 të këtij neni me nenin 1 të udhëzimit të përgjithshëm nr.04/2022)

1. Drejtuesi i prokurorisë, realizon mbikëqyrjen periodike të veprimtarisë procedurale penale, sipas fazave të procedimit penal, dhe sipas prioriteteve të udhëzuara/rekomanduara, nëpërmjet ushtrimit të kompetencave:

a) jep urdhra të detyrueshëm për policinë gjyqësore dhe mbikëqyr zbatimin e tyre lidhur me ushtrimin e funksioneve sipas ligjit³¹ si dhe monitoron efikasitetin dhe efektivitetin e veprimtarisë së tyre për rritjen e përgjegjshmërisë e llogaridhënies së brendshme në zbatim dhe të këtij udhëzimi;

b) kërkon informacion për ecurinë e procedimeve dhe verifikon ecurinë dhe/ose përfundimin e çështjes, sipas ligjit³²;

c) nxjerr udhëzime me shkrim jo të detyrueshme sipas ligjit³³ kur e vlerëson të nevojshme;

ç) merr vendim me shkrim për zëvendësimin e prokurorit ose oficerin e policisë gjyqësore për rastet e parashikuara në ligj³⁴.

2. Drejtuesi i prokurorisë realizon mbikëqyrjen periodike të veprimtarisë së prokurorisë, edhe nëpërmjet analizës së treguesve të gjendjes së kriminalitetit, mbarëvajtjes së punës, efikasitetit dhe efektivitetit në ushtrimin e ndjekjen penale sipas prioriteteve të udhëzuara/rekomanduara, si dhe vlerësimit të performancës së prokurorisë që drejton, dhe sipas ligjit:

a) informon çdo tre muaj Prokurorin e Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit³⁵ në rrethin gjyqësor të prokurorisë që drejton;

b) raportin vjetor mbi ecurinë e punës në prokurorinë përkatëse³⁶ ia dërgon Prokurorit të Përgjithshëm brenda muajit shkurt të çdo viti;

c) është përgjegjës për mbarëvajtjen e punës dhe marrjen e masave dhe veprimeve për të siguruar efikasitetin dhe ligjshmërinë e veprimtarisë së prokurorisë që drejton³⁷;

ç) është përgjegjës për drejtimin, mbarëvajtjen e punës dhe marrjen e masave për bashkërendimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së policisë gjyqësore nën

³¹ Neni 43, shkronja "c" e ligjit nr.97/2016 dhe neni 7 pika 5 të ligjit nr.25/2019;

³² Neni 43, shkronjat "b" e "ç" të ligjit nr.97/2016;

³³ Neni 43, shkronjat "ç" dhe neni 48 të ligjit nr.97/2016;

³⁴ Neni 49 i ligjit nr.97/2016 dhe nenet 26 e 27 të K.Pr.Penale;

³⁵ Neni 42, shkronja "l" e ligjit nr.97/2016;

³⁶ Neni 52, pika 2 e ligjit nr.97/2016;

³⁷ Neni 52, pika 1 e ligjit nr.97/2016;

juridiksionin e tij³⁸, për të siguruar efikasitetin dhe ligjshmërinë e kësaj veprimtarie në prokurorinë që drejton;

ç/i) informon brenda 15 ditësh sektorin e monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme në rastet kur evidenton problematika dhe/ose shkelje që përbëjnë shkak për fillimin e procedurës disiplinore ndaj oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit në prokurorinë që drejton, bazuar në analiza dhe vlerësime të treguesve të volumit të punës së kryer prej tyre sipas të dhënave statistikore të sistemit elektronik SVHOPGJP që parashikon neni 8/a i këtij udhëzimi.

d) raportin e vlerësimit të oficerëve të Policisë Gjyqësore³⁹ ia dërgon Komisionit të Policisë Gjyqësore⁴⁰ dhe Prokurorit të Përgjithshëm⁴¹.

3. Strukturat në Prokurorinë e Përgjithshme, me fokus objektin e veprimtarisë së tyre, krahas informacioneve të marra në zbatim të pikës 2 të këtij neni, realizojnë mbikëqyrje dhe/ose verifikime nëpërmjet kërimit dhe administrimit në mënyrë periodike, dhe jo vetëm, të të dhënave ose informacioneve nga drejtuesit e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm lidhur me:

a) ecurinë e veprimtarisë procedurale penale dhe administrative të prokurorisë që drejtojnë⁴²;

b) gjendjen e treguesve të kriminalitetit, të dhëna dhe shpjegime për numrin, llojet, shtrirjen territoriale, intensitetin dhe format e kriminalitetit⁴³ në rrethin gjyqësor të prokurorisë që drejton;

c) ecurinë e zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme, nëse janë nxjerrë udhëzime të përgjithshme për të lehtësuar zbatimin e tyre ose udhëzime jo të detyrueshme për çështje konkrete në zbatim të udhëzimeve/rekomandimeve përkatëse, përfshirë dhe si kanë ndikuar ato mbi gjendjen e kriminalitetit dhe në fushat e rekomanduara⁴⁴;

ç) ecurinë e zbatimit të rezolutave të Kuvendit të Shqipërisë dhe rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave, sipas ligjit⁴⁵;

d) ecurinë e zbatimit të memorandumeve/marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërinstytucional;

3.1 Strukturat në Prokurorinë e Përgjithshme, pas analizës dhe vlerësimit të të dhënave të marra, sipas objektit të veprimtarisë, përgatisin informacion përmbledhës për Prokurorin e Përgjithshëm për gjetjet nga monitorimet dhe propozojnë zgjidhje afatshkurtëra dhe/ose afatgjata, në nivel politikash, ndryshime/shtesa në akte normative, nevojë për ngritje profesionale, inspektive tematike ose hetime për shkelje individuale të rastit, siç parashikohet në nenet 5 (1.1), 7, 8 e 8/a pika 5 të këtij udhëzimi.

³⁸ Neni 42 shkronja "gj" e ligjit nr.97/2016 dhe neni 7 pika 2 e ligjit nr.25/2016;

³⁹ Neni 42, shkronja "gj" e "k" të ligjit nr.97/2016;

⁴⁰ Neni 42, shkronjat "e" e "k", neni 50 pika 1 në lidhje me nenin 38 pikat 1, 2 shkronjat "b", "f" e "i" e vijues të ligjit nr.97/2016;

⁴¹ Neni 42, shkronjat "e" e "k", neni 50 pika 1 në lidhje me nenin 38 pikat 1, 2 shkronjat "g", "gj" e vijues të ligjit nr.97/2016;

⁴² Neni 50, pika 1 e ligjit nr.97/2016;

⁴³ Neni 42 shkronja "l" në lidhje me nenin 104 pika 1 të ligjit nr.97/2016;

⁴⁴ Neni 38 pika 2 shkronja "b" në lidhje me nenin 46 pika 4 dhe nenin 104 pika 2 shkronja "b" të ligjit nr.97/2016;

⁴⁵ Neni 103 në lidhje me nenin 104 pika 2 të ligjit nr.97/2016;

Neni 7

Shqyrtimi, verifikimi, vlerësimi dhe zgjidhja e ankesave/kërkesave

1. Struktura e monitorimit, me marrjen e një ankese nga persona fizikë ose juridikë⁴⁶ ose një informacion i lidhur me problematika të konstatuara nga ushtrimi funksioneve në struktura të tjera të Prokurorisë së Përgjithshme, ndjek procedurën sipas detyrave funksionale të parashikuara në aktin normativ⁴⁷.

a) Në rastet kur nga analiza e të dhënave të administruara, rezulton se është kryer një shkelje disiplinore nga prokurori, në relacion analizon edhe kriteret e parashikuara në ligj⁴⁸ dhe i sugjeron Prokurorit të Përgjithshëm, sipas rastit, t'i kërkojë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë hetime për shkeljet individuale, ose arkivimin e ankesës kur janë kushtet ligjore.

b) Në rastet kur nga analiza e të dhënave të administruara, rezulton se është i nevojshëm inspektimi tematik në relacion analizon dhe vlerëson edhe shkaqet për kërkimin e inspektimeve tematike nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë;

d) Në rastet kur nga analiza e të dhënave të administruara, rezulton se është kryer një shkelje disiplinore nga oficeri i policisë gjyqësore, në relacion analizon të dhëna të detajuara për shkeljet e pretenduara dhe i sugjeron Prokurorit të Përgjithshëm t'i kërkojë Komisionit të Policisë Gjyqësore, fillimin e hetimeve për shkelje disiplinore, sipas ligjit.⁴⁹

Neni 8

Mbikëqyrja e veprimtarisë së policisë gjyqësore

(Shtesat në pikën 1 shkronja "a" dhe pika 5 shkronja "a" të këtij neni me nenin 2 të udhëzimit të përgjithshëm nr.04/2022)

1. Mbikëqyrja e veprimtarisë së oficerëve të policisë gjyqësore, realizohet ndëpërmjet:

a) marrjes së informacionit nga drejtuesit e prokurorisë për veprimtarinë e oficerit dhe etikën, si dhe të dhëna statistikore për volumin e punës sipas nenit 8/a të këtij udhëzimi, shpejtësinë, cilësinë e akteve dhe problematikat e konstatuara në kryerjen e hetimeve;

b) mbikëqyrjes tematike, për grupvepra ose seksione pranë prokurorive, të cilat nga raportet dhe analizat e kryera, rezultojnë problematike në drejtim të efikasitetit në kryerjen e hetimeve penale dhe/ose respektimin e kërkesave ligjore procedurale penale.

2. Në rastin e parashikuar në shkronjën "a" të pikës 1 të këtij neni, informacioni kërkohet nga Sektori i Monitorimit në mënyrë periodike dhe sipas rastit kur vlerësohet e

⁴⁶ Koment: Personat fizikë ose juridikë mund të jenë qytetarë, subjekte shtetërore ose organizata që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e të drejtave të njeriut, apo të tjera të lidhura me sistemin e drejtësisë penale.

⁴⁷ Shih, Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme, e miratuar me urdhrin nr.136, datë 28.10.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm;

⁴⁸ Neni 120 i ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"

⁴⁹ Neni 35/3 i ligjit 25/2019

nevojshme lidhur me veprimtarinë e oficerit/ve, ndëkohë kthimi i përgjigjes kryhet pa vonesë brenda afatit të kërkuar.

3. Në rastin e parashikuar në shkronjë "b" të pikës 1 të këtij neni, Prokurori i Përgjithshëm nxjerr një urdhër të posaçëm për ngritjen e grupit të kontrollit, ku përcaktohet objekti dhe afati i kryerjes së tij.

4. Sektori i monitorimit, është përgjegjës për përgatitjen e korrespondencës, administrimin e përgjigjeve dhe mbështetjen e nevojshme të grupit të monitorimit.

5. Pas administrimit të gjithë informacionit dhe dokumentacionit të nevojshëm, sektori i monitorimit në rastin e parashikuar në shkronjën "a" të pikës 1 të këtij neni, dhe grupi i monitorimit në rastin e parashikuar në shkronjë "b" të pikës 1 të këtij neni, harton raportin e monitorimit, i cili duhet të përmbajë:

a) të dhëna statistikore për ngarkesën e punës së oficerit, përfshi dhe volumin e veprimeve hetimore, verifikimeve pasurore ose veprimeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale, të kryera nga oficeri/ët e policisë gjyqësore të seksionit në prokurori, sipas të dhënave të sistemit elektronik që normon neni 8/a i këtij udhëzimi, për periudhën objekt monitorimi.

b) cilësinë për veprimtarinë dhe aktet procedurale;

c) të dhëna që lidhen me etikën e oficerit gjatë kryerjes së detyrës;

ç) evidentohen vlerat pozitive të tij;

d) kur është rasti, vërejtje dhe rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë së opgj-së;

dh) kur konstatohen shkelje të ligjit apo të urdhrave e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, përshkruhen shkeljet dhe vlerësohet rëndësia e tyre;

e) kur është rasti, i propozohet Prokurorit të Përgjithshëm t'i kërkojë Komisionit të Policisë Gjyqësore fillimin e hetimit disiplinor sipas ligjit.

6. Një kopje e raportit të monitorimit të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm, i dërgohet Komisionit të Policisë Gjyqësore.

Neni 8/a

Sistemi elektronik "Statistika e veprimeve hetimore të oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit në prokurori" (SVHOPGJP)

Shtuar ky nen me nenin 3 të udhëzimit të përgjithshëm nr.04/2022)

1. Në seksionet e policisë gjyqësore të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, krijohet dhe vihet në funksionim sistemi elektronik (SVHOPGJP) për plotësimin/hedhjen, administrimin dhe përfundimin e statistikave periodike, me të dhëna për numrin e veprimeve hetimore apo ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale në kuadrin e procedimit penal ose për numrin e veprimeve verifikuese pasurore në kuadrin e procedimit pasuror, të kryera nga oficerët e policisë gjyqësore të seksionit në prokuroritë përkatëse.

2. Secili oficer i policisë gjyqësore në seksionin e prokurorisë përkatëse, për numrin e veprimeve hetimore⁵⁰ të dokumentuara që kryen me iniciativë ose të urdhëruara/deleguara nga prokurori⁵¹ sipas ligjit, ashtu dhe për verifikimet pasurore⁵² ose veprimet⁵³ për ekzekutimin e vendimeve penale, si për referimet penale dhe për procedimet penale në ndjekje sipas fazave⁵⁴, ashtu dhe për procedimet/hetimet pasurore ose për ekzekutimin e vendimeve penale, hedh/plotëson periodikisht çdo 15 ditë, të dhëna në fushën e rubrikës përkatëse të sistemit elektronik (SVHOPGJP), për numrin e veprimeve hetimore apo verifikuese pasurore ose veprimeve për ekzekutimin e vendimeve penale, të kryera për secilin referim/ankim, procedim penal apo procedim pasuror ose vendim gjyqësor penal i urdhëruar për ekzekutim në ndjekje apo të përfunduar, sipas udhëzimeve teknike në Manualin e Përdorimit të tij⁵⁵, bashkëlidhur këtij udhëzimi si pjesë e tij.

3. Në formatin standard të këtij sistemi elektronik shënohen të dhëna sipas rubrikave:

a) në rubrikën “Numër procedimi”, oficeri i policisë gjyqësore plotëson numrin e regjistrimit të procedimit penal ose numrin e procedimit penal i lidhur me vendimin gjyqësor penal të urdhëruar për ekzekutim, që oficeri ka marrë për veprim;

b) në rubrikën “Numër hetimi/procedimi pasuror”, oficeri i policisë gjyqësore plotëson numrin e regjistrimit të procedimit/hetimit pasuror, të marrë për veprim prej tij;

c) në rubrikën “Datë regjistrimi të procedimit”, oficeri i policisë gjyqësore plotëson datën e regjistrimit sipas rastit të procedimit penal ose procedimit/hetimit pasuror;

ç) në rubrikën “Numër veprimesh” oficeri i policisë gjyqësore plotëson me shifra numrin e veprimeve hetimore të dokumentuara që ka kryer për secilin procedim penal ose hetim pasuror apo për ekzekutimin e vendimit gjyqësor penal i urdhëruar ekzekutimi, sipas statusit, i hapur ose i mbyllur, në periudhën periodike objekt raportimi;

e) në rubrikën “statusi i hapur” përfshihen sipas rastit referimi i policisë gjyqësore, ankimi për veprat penale që ndiqen me ankimin e të dëmtuarit apo procedimi penal ose procedimi pasuror apo vendimi gjyqësor penal, që oficeri i policisë gjyqësore i seksionit ka në ndjekje apo për zbatim, ndërsa në rubrikën “statusi i mbyllur” përfshihen sipas rastit referimi/ankimi apo procedimi penal ose procedimi/hetimi pasuror apo vendimi gjyqësor

⁵⁰ Shih nenin 303 “Dokumentimi i veprimeve hetimore të policisë gjyqësore”, ku në zbatim të këtij udhëzimi përfshihen llojet e veprimeve të dokumentuara që parashikon pika 2 shkronjat “a” deri “d” të këtij neni që kryen policia gjyqësore e seksionit në prokurori;

⁵¹ Shih po aty, nenin 303 shkronja “e” për veprimet e deleguara nga prokurori, ku në zbatim të këtij udhëzimi përfshihen llojet e veprimeve të dokumentuara që parashikojnë shkronjat “a” deri “d” tek pika 2 e këtij neni.

⁵² Shih nenin 6 “Objekti hetimit” i ligjit 10192/2009 i ndryshuar, i cili në pikën 1 parashikon: “1. Prokurori ndërmerr, edhe nëpërmjet policisë gjyqësore, hetimet e nevojshme ..., për mjetet financiare, pasuritë, veprimtaritë ekonomike, tregtare dhe profesionale, nivelin ekonomik dhe burimet e të ardhurave të tyre, si dhe pyetjen e personave që kanë dijeni mbi faktet objekt i këtij ligji dhe kryerjen e ekspertimeve të nevojshme...”

⁵³ Koment: Veprim për ekzekutimin e vendimeve penale është procesverbali që mban oficeri i policisë gjyqësore për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale të urdhëruara nga prokurori, sipas fazave dhe niveleve të prokurorisë pranë gjykatave përkatëse me juridiksion të përgjithshëm.

⁵⁴ Koment: Veprimet hetimore dhe/ose të urdhëruara/deleguara nga prokurori mund të kryhen, si në fazën e hetimeve paraprake dhe në fazën e gjykimit kur janë rastet dhe mundësitë për administrimin e provave të reja, ashtu dhe veprimet për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të urdhëruara nga prokurori për masat e sigurimit personal dhe/ose pasuror, etj.

⁵⁵ Manuali “Manual përdorimi për sistemin elektronik të oficerave të policisë gjyqësore në prokurori”.

penal objekt ekzekutimi, që ai ka përfunduar sipas mënyrave të përfundimit që parashikon ligji⁵⁶.

4. Në sistemin elektronik SVHOPGJP oficeri i policisë gjyqësore i seksionit përditëson çdo 15 ditë të dhënat për veprimet proceduriale të kryera gjatë kësaj periudhe për secilin referim/ankim apo procedim penal ose procedim/hetim pasuror apo vendim gjyqësor penal i urdhëruar për ekzekutim, në ndjekje ose i përfunduar gjatë kësaj periudhe periodike objekt monitorimi nga drejtuesi i prokurorisë përkatëse dhe nga personi i caktuar në Sektorin e Monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme (SMPP), sipas parashikimeve në nenin 6 të këtij udhëzimi,

5. Në të dhënat statistikore periodike 15 ditore të sistemit elektronik SVHOPGJP kanë akses të drejtpërdrejtë për të përfituar informacion:

a) drejtuesi i prokurorisë përkatëse, i cili pasi njihet analizon dhe vlerëson të dhënat statistikore për numrin e veprimeve hetimore të kryera nga secili oficer i policisë gjyqësore dhe/ose nga gjithë oficerët e seksionit të policisë gjyqësore në prokurorinë që drejton, si dhe kur evidenton problematika dhe/ose shkelje, informon SMPP sipas parashikimit në shkronjën “ç/i” të pikës 2 të nenit 6 të këtij udhëzimi.

b) personi i caktuar në Sektorin e Monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme, i cili ka akses për tu njohur, analizuar dhe vlerësuar të dhënat statistike për numrin e veprimeve proceduriale të kryera nga oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve në gjithë prokuroritë, për të evidentuar performancën e seksioneve të policisë gjyqësore në prokurori dhe të oficerëve të policisë gjyqësore pranë tyre, si dhe llogaridhënien në ushtrimin e funksioneve të tyre, me synim rritjen e efikasitetit në veprimtarinë hetimore të seksioneve në prokurori, rritjen e efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit sipas prioritetëve dhe reduktimin e afateve të kohëzgjatjes së hetimeve paraprake. Ai përgatit informacion përmbledhës periodik 3 muaj për Prokurorinë e Përgjithshme për gjetjet nga monitorimet dhe propozon zgjidhje sipas parashikimeve në pikën 3.1 të nenit 6 të këtij udhëzimi.

KREU IV

MARRËDHËNIET INSTITUCIONALE DHE BASHKËPUNIMI ME INSPEKTORATIN E LARTË TË DREJTËSISË dhe KOMISIONIN E POLICISË GJYQËSORE

Neni 9

Marrëdhëniet institucionale me ILD dhe KPGJ

⁵⁶ Shih, K.Pr.Penale nenet 290 e 291 për rastet e mosfillimit të procedimit penal lidhur me kallëzimet, referimet apo ankimet e përfunduara/mbyllura dhe nenet 326, 327 pika 6 shkronjat “a” e “b” dhe 328 për rastet dhe llojet e përfundimit/mbylljes së procedimeve penale si dhe përfundimin/mbylljen e hetimeve pasurore me konfiskim pasurie apo pushimi të hetimit pasuror sipas nenit 21 e vijues të ligjit nr.10192/20009 i ndryshuar.

1. Prokurori i Përgjithshëm, depoziton kërkesë pranë ILD-së për inspektime tematike ose hetimin për shkelje individuale, në rastet kur ka të dhëna të besueshme se është kryer shkelje disiplinore, e konstatuar nëpërmjet:

- a) mbikëqyrjes/monitorimit të zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme;
- b) informacioneve periodike mbi ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore të prokurorisë;
- c) kryerjes së analizave e raporteve lidhur me ecurinë e veprimtarisë së prokurorive me juridiksion të përgjithshëm;
- c) informacione nga institucione e burime të tjera.

2. Prokurori i Përgjithshëm, depoziton kërkesë pranë KPGJ-së për fillimin e hetimeve për shkelje disiplinore dhe ankesa, në rastet kur ka të dhëna të besueshme se është kryer shkelje disiplinore nga oficeri i policisë gjyqësore.

3. Kërkesës, sipas rastit i bashkëlidhet dokumentacioni i nevojshëm lidhur me faktet, indiciet dhe provat që kanë shërbyer për të besuar se është kryer një shkelje disiplinore.

4. Prokurori i Përgjithshëm, kërkon kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike në një apo disa prokurori nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, duke parashtruar në kërkesë nevojën e inspektimit, problematikat e konstatuara dhe sugjeruar objektin e inspektimit, sipas rastit.

Neni 10

Bashkëpunimi ndërinstitutional me ILD-në dhe KPGJ-në

1. Struktura e monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme siguron bashkëpunimin e drejtuesve të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm për të lehtësuar procesin e marrjes së informacionit dhe ushtrimit të funksioneve nga inspektorët e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;

2. Kjo strukturë organizon takime të përbashkëta dhe shkëmben eksperiencë profesionale me inspektorët e ILD-së në fushën e inspektimit dhe hetimeve disiplinore, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave më të mira dhe adresimin e problematikës së hasur si gjatë verifikimeve, ashtu dhe gjatë inspektimeve.

KREU V

NJOHJA, SHKELJET DISIPLINORE, ZBATIMI, HYRJA NË FUQI DHE PUBLIKIMI

Neni 11

Njohja

Me këtë udhëzim të përgjithshëm të njihen prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme, drejtuesit e prokurorive, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm.

Neni 12

Shkeljet dhe verifikimet disiplinore

Shkelja e dispozitave ligjore referuese në këtë udhëzim të përgjithshëm dhe/ose moszbatimi i normimeve të përcaktuara në këtë udhëzim, mund të përbëjnë, shkelje disiplinore sipas ligjit⁵⁷ dhe/ose shkak për nisjen e verifikimeve nga struktura përkatëse sipas ligjit

Neni 13

Zbatimi dhe mbikëqyrja

1. Ky udhëzim është i detyrueshëm për zbatim nga drejtuesit dhe prokurorët në strukturat e Prokurorisë së Përgjithshme, drejtuesit e prokurorive, zëvendësprokurorët e prokurorive, prokurorët dhe nga oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe shërbimeve në strukturat policore të Policisë së Shtetit dhe shërbime policore të tjera sipas ligjit.

2. Me mbikëqyrjen e zbatimit të këtij udhëzimi të përgjithshëm ngarkohen drejtuesit e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe Sektori i Monitorimeve në Prokurorinë e Përgjithshme.

3. Drejtuesit e prokurorive mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme për lehtësimin e zbatimit të këtij udhëzimi të përgjithshëm.⁵⁸

Neni 14

Hyrja në fuqi dhe publikimi

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe të publikohet në faqen e internetit të Prokurorisë Përgjithshme.

⁵⁷ Shih, nenin 148/d paragrafi 1 i Kushtetutës dhe nenet 101 pika 1 shkronja "a" "b" dhe 102 pika 1 shkronjat "c" "ç", "d" "dh", "e", "g", "i", "j", "nj"; pika 2 shkronjat "a", "b", "c", "ç", "d", "dh" të ligjit nr.96/2016, i ndryshuar me ligjin nr.48/2019 dhe neni 89 e vijues të ligjit nr.97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", si dhe neni 33 i ligjit nr.25/2019 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë Gjyqësore"

⁵⁸ Shih, neni 46 pika 4 i ligjit nr.97/2016..